



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 260, datë 28.12.2018

MBI

FONDIN E KOMPENSIMIT PËR VITIN 2019

Në bazë dhe për zbatim të neneve 13, 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 45 e vijues të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Fondi i Kompensimit krijohet bazuar në nenin 45 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe ka për qëllim pagesën e dëmeve pasurore dhe jo pasurore të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur dëmet shkaktohen nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i siguruar sipas ligjit nga ndonjë shoqëri sigurimi, nga një mjet motorik i pidentifikuar apo në rastet e mbylljes apo falimentimit të një shoqërie sigurimi.

Autoriteti, me propozim të Byrosë, vendos çdo vit shumën e kontributeve, sipas pikave 2 e 3, shkronja b e këtij neni dhe afatin brenda të cilit duhet të bëhet derdhja.

Referuar pikës 5 të nenit 3, të Rregullores nr. 36, datë 21.03.2012 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”, si dhe pikës 1 të nenit 7, të Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010 “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së BSHS-së”, e ndryshuar, Byroja brenda datës 30 nëntor të çdo viti, i propozon për miratim Autoritetit shumën e kontributeve të çdo shoqërie sigurimi për financimin e Fondit të Kompensimit të vitit pasardhës.

Autoriteti miraton çdo vit brenda datës 31 dhjetor, shumën e këtyre kontributeve.

Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të BSHS-së në mbledhjen e datës 18 dhjetor 2018, shqyrtoi Fondin e Kompensimit, situatën e çështjeve gjyqësore dhe me vendimin nr. 27 datë 18.12.2018, vendosi:

1. Shpërndarjen e Fondit të Kompensimit për periudhën 01 janar 2019 deri 31 dhjetor 2019 në masën 100,000,000 lekë, për pagesat e detyrimeve nga Fondi i Kompensimit;
2. Fondi do të rishikohet sipas nevojave që do të lindin gjatë vitit 2019.

Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të BSHS-së, nr. 27, datë 18.12.2018 “Për miratimin e shpërndarjes së masës së kontributit për Fondin e Kompensimit për vitin 2019”, është depozituar nëpërmjet email-it vetëm më datë 26.12.2018.

Referuar të dhënave të paraqitura nga BSHS në mbledhjen e datës 18 dhjetor 2018, për ngjarjet deri 31.12.2013 si dhe inspektimit të kryer pranë shoqërive të sigurimit, sipas programit të inspektimit 4083, datë 11.12.2018, për ngjarjet pas 1 janar 2014 e në vazhdim, situata paraqitet:

| Sipas statusit të praktikës | Ngjarje deri 31.12.2013 | Ngjarje pas 1 janar 2014 |
|--|----------------------------|-----------------------------|
| 1. Dëme të miratuara por të papaguara | 11,098,321 | 100,654,972 |
| 1.1 Dëme të miratuara në proces pagese | 0 | 96,736,098 |
| <i>Në proces pagese dhe marrëveshje</i> | | 52,877,973 |
| <i>Mbetur për tu paguar</i> | | 43,858,125 |
| 1.2 Dëme me vendime gjyqësore të formës së prerë | 11,098,321 | 3,918,874 |
| 2. Dëme në proces | 282,103,711 | 455,389,398 |
| 2.1 Dëme në proces trajtimi | 0 | 154,363,088 |
| 2.1 Dëme në proces gjyqësor shkallë e parë | 74,613,596 | 153,807,833 |
| 2.2 Dëme në proces gjyqësore Apel dhe Shkallë e lartë | 207,490,115 | 147,218,477 |
| <i>Detyrimi për Dëme Pezull Fond Kompensimi</i> | 293,202,032 | 556,044,370 |

Në funksion të misionit të AMF-së për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, problematikave ndër vite në tregun e sigurimeve me Fondin e Kompensimit, vlerësohet se shuma e propozuar nga BSHS-ja sipas vendimit nr. 27, datë 18.12.2018 “Për miratimin e shpërndarjes së masës së kontributit për Fondin e Kompensimit për vitin 2019”, është e pamjaftueshme.

Përsa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Për vitin 2019, Fondi i Kompensimit për shlyerjen e detyrimeve që do të krijohen për pagesat e dëmeve të krijohet minimalisht në masën 566,461,885 lekë, i ndarë:
 - 1.1 Fondi i Kompensimit në vlerën 218,588,436 lekë, për shlyerjen e detyrimeve për pagesat e dëmeve me datë ngjarje sigurimi deri në 31.12.2013 (që i përket praktikave të përfunduara në vlerën 11,098,321 lekë si dhe praktikave në proces gjyqësor në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë);

- 1.2 Fondi i Kompensimit në vlerën 247,873449 lekë, për shlyerjen e detyrimeve për pagesat e dëmeve me datë ngjarje sigurimi pas 1 janar 2014 e në vazhdim (që i përket praktikave të përfunduara në vlerën 100,654,972 lekë si dhe praktikave në proces gjyqësor në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë);
- 1.3 Fondi i Kompensimit në vlerën minimale prej 100,000,000 lekë, për shlyerjen e detyrimeve për pagesat e dëmeve me datë ngjarje sigurimi nga 01.01.2019 – 31.12.2019.
2. Shoqëritë e sigurimit të krijojnë provigjon për shpenzime në pasqyrat financiare të vitit 2019, shumën totale prej 382,784,517 lekë, që i përket praktikave në proces trajtimi dhe në proces gjyqësor në Gjykatën e Shkallës së Parë.
3. Byroja Shqiptare e Sigurimit:
- 3.1 Të llogaritë dhe të njoftojë shoqëritë e sigurimit për vlerën respektive të Fondit të Kompensimit sipas pikës 1 të këtij vendimi;
- 3.2 Të llogaritë dhe të njoftojë shoqëritë e sigurimit për vlerën respektive për krijimin e provigjonit për shpenzime sipas pikës 2 të këtij vendimi.
4. Fondi i Kompensimit sipas pikës 1 të këtij vendimi do të derdhet në llogarinë qëllimore sipas afateve të përcaktuar në pikën 9, të Rregullores nr. 36, datë 21.03.2012 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”.
5. Fondi i Kompensimit dhe provigjoni i parashikuar për vitin 2019, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi do të rishikohen në fund të çdo tremujori.
6. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Juridike, Drejtoria e Zbatueshmërisë dhe Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin e vendimit, ndjekjen e raportimeve, kryerjen e inspektimeve dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në menjëherë.

ANËTAR

Klodion SHEHU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI